

... *histori...*

❖ Qyteti i Shkodrës është themeluar në shek. IV para Krishtit prej fisit ilir të Labeateve. Në këtë kohë qyteti merr një zhvillim ekonomik, gjë që dëshmohet nga prerja e monedhës në qytet që në vitin 230 para Krishtit. Nga monedha mësojmë emrin që ka qyteti në atë kohë, Scodrinon.

Në kohën kur popullsia ilire e territorit shqiptar kishte arritur zhvillimin më të lartë ekonomik e kulturor, në vitin 181 p.k. bëhet Kryeqyteti i Mbretërisë Ilire.

Nga gjysma e dytë e shek. II p. k. (viti 168 p.k.) deri në kohën e reformave të Dioklecianit, Shkodra ishte koloni romake e pastaj kryeqyteti i provincës Prevalitana. Në këtë kohë afërsisht është edhe seli peshkopale.

Me ndarjen e Perandorisë Romake, Shkodra, sikurse e gjithë Iliria e jugut, kalon nën kontrollin e Bizantit, e duke e parë që ishte e rëndësishme si qëndër fetare, vazhdon të varet prej Kishës së Romës. Duke përballuar invazionet e shumta të Barbarëve që përshkuan territorin shqiptar ndërmjet shekujve XI e XIV, Shkodra përjeton edhe një periudhë të shkurtër vetëqeverisjeje, në pjesën e dytë të shek. XIV (viti 1360), duke qenë kryeqendër e shtetit feudal të familjes Balshaj, para se të kalojë nën vartësinë e Venedikut në shek. XV (vitet 1396-1479). Në këtë kohë rikonstruhohet kalaja (e cila filloi të ndërtohet në shek. V-IV) dhe qyteti merr emrin Scutari.

Pushtimi i plotë i Shqipërisë përfundon vetëm mbas pushtimit të Shkodrës (1479, 10 vjet pas vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastrioti), si qyteti i fundit shqiptar i pa pushtuar nga Perandoria Osmane.

Gjatë sundimit turk, Shkodra bëhet qëndër administrative e sanxhakut. Nga gjysma e dytë e shek. XVIII e në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XIX në Shkodër ndodh një përpjekje tjetër për shpëtim nga Stambolli e udhëhequr prej familjes feudale të Bushatllinjëve.

Më pas, në Shkodër, si qëndër e vilajetit, do të kenë selitë e tyre konsullatat e fuqive të mëdha të Europës (1718).

Më 1730 krijohet dhoma e tregtisë.

Rilindja kombëtare e Shqipërisë (1830-1912) e gjen Shkodrën me 50 000 banorë dhe protagoniste, me një rritje të vrullshme ekonomike e kulturore. Falë pozitës gjeografike, bëhet një nyje e rëndësishme tregtare për trafikun ndërmjet brigjeve të Adriatikut e Krahinave të brendshme të Ballkanit.

Më 1807 – 1809 ndërtohet bexhisteni në zonën tregtare të qytetit, Pazari i Vjetër, një kompleks i rëndësishëm i ngritur përbri kodrës mbi të cilën ndodhet kalaja Rozafa, dhe që përbëhet nga 2 500 dyqane e ku ushtrohen rreth 80 lloje zejesh. Afër pazarit ekzistonte një molo në lumin Bunë ku ankoroheshin barka e anije të vogla nëpërmjet të cilave Shkodra dhe Pazari i saj lidheshin me Adriatikut.

Gjatë shek. XX qyteti do të provojë dy herë pushtimin e shkurtër nga ushtritë serbo – malazeze.

Konferenca e ambasadorëve në Londër e kishte njohur Shkodrën si pjesë e shtetit shqiptar dhe për dy vjet 1913-1914 do të administrohet prej Komisionit Ndërkombëtar të Fuqive të Mëdha.

Në 1915 sulmohet nga ushtria malazeze dhe në janar 1916 pushtohet nga austriaket të cilet e bëjnë Shkodrën qëndër të zonës së tyre të pushtimit.

Mbas Kongresit të Lushnjës 1920 qyteti administrohet nga qeveria shqiptare që doli nga ky Kongres.

Në vitet 1924 – 1939 pati një zhvillim industrial kryesisht me fabrika të vogla. Në këtë kohë numërohen rreth 70 fabrika. Gjatë periudhës së monarkisë qyteti ka një administrim europian me institucione të rregullta dhe u kryen një varg reformash progresiste.

Në vitin 1939 – 1944 pushtimi nazi-fashist

Më 1945 vendoset diktatura komuniste .

Sinjalet e para të lëvizjes demokratike të vitit 1990 u dhanë në Shkodër në Janar të këtij viti.

❖ Në shek. XV në trevat që përbënin më parë principatën e Pultit, u formuan ndarjet më të vogla etnografike. Këto bashkësi ekonomike-shoqërore shkuan drejt përqëndrimit në shekujt e mëpasëm duke marrë emrin e përbashkët Malësi (nga organizimi në “male”). Për mbrojtjen e saj, Malësia e Madhe ngriti edhe forca të bashkuara ushtarake, që luajtën rol në luftrat e ndryshme.

Popullsia merrej kryesisht me blegtori.

Marëdhëniet shoqërore rregulloheshin sipas Kanunit të Maleve. E folura bën pjesë në gegërishten veriore.

Tipi i banesës ishte shtëpia e zgjatur, ndërsa në shek. XX u përgjithësua një variant i kullës.

Kopliku (sot qendra e Malësisë së Madhe) përmendet që në shek. XV me emrin Kopenik Në Koplikun e sipërm është kështjella e vjetër e Barlecës , që vendasit e njohin me emrin kalaja e Podgorës, e ndërtuar në shek. I-II pas Krishtit.

Malësia e Madhe është treva ku janë ruajtur deri më sot gjallë cikli i kreshnikëve, përdoret lahuta e fyelli, dhe ka një tip valle që kërcëhet pa shoqërim muzikor.

❖ Formimi krahinor i Pukës lidhet me periudha të caktuara historike .

Në lashtësi Puka banohej prej fisit Ilir të Pirusit. Si ish qendër kazaje ka një vazhdimësi rreth 2 000 vjeçare. Në hartat romake të shek. II-IV shënohet Ad Picaria (që në shqip ka kuptimin “në Pezhkve”, sot lagje me këtë emër), qytet shënuar “XXX milje në verilindje të Lisusit , në udhën verilindore Lisus e Scodra – Dardani”.

Në shek. VI në veprën “Ndërtimet” të kohës së sundimit të Perandorit Justinian, kështjella e Pukës (Pucas) shënohet si një nga kështjellat e rëndësishme të Ballkanit.

Nga mesjeta e hershme deri në shek. XIII, Puka përbënte këndin juglindor të Principatës së Gentës si dhe të krahinës Pulatum.

Në shek. XII-XV Puka është në qendër të principatave të Dukagjinit. Rezistenca e gjatë antiosmane u kurorëzua me sigurimin e autonomisë krahinore por me pasoja të rënda, pastaj, me Rilindjen Kombëtare u arrit një farë përtëritje nëpërmjet forcimit të lidhjeve krahinore (deri në Kosovë).

Në vitet 1878–1881 dhe në 1885 Puka u bë mbështetje e sigurtë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Krahina e Pukës u përfshi në të gjitha rezistencat kundër serbo-malazezeve, austro-hungarezëve dhe atyre të dy Luftrave Botërore.